

Data 04.10.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikualifikimi i blloqeve urbane Rajoni 3, (Zona historike A-Pogradec) : Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i Qendrës Historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Pogradecit”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

VLERA E FONDIT LIMIT: 541,526,784.36 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor GOA për periudhën 2024-2026, Kodi i Projektit 24AF102

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore të situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

N.P – 1	A	Punime gjurmimi në tokë
N.P – 2	D	Ndërtime civile dhe industriale
N.P – 4	B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
N.P – 5	D	Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti
N.P – 11	C	Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike
N.P – 12.	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

N.S – 1	B	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S – 2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
N.S – 18	A	Punime topogjeodezike.

- Për punimet e restaurimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N-Z/A/5 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së traditës (venrakulare)

N-Z/A/6 Zbatim në konservim dhe restaurim I arkitektures së projektuar

N-Z/A/7 Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim I hapësirave (Rrugë, sheshe) Brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P- 1 A	Punime gjurmimi në tokë.	<ul style="list-style-type: none"> - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 7.0 km - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km - Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 7.0 km - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km - Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km - Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet - Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme - Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak. - Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme - Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m² - Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km - Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet - Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme - Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak. - Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak. - Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m² - Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke 	0-20 milion lekë	13,265,973 leke
N.P- 2 D		<ul style="list-style-type: none"> - Skele me tubo fasade ~ 8m - Skele me tubo tavani ~ 8m - Parapet shkalle e ballkone mur tulle+suva+korimano druri - Boje hidroplastike cilesi e larte - F.V porte metalike dekorative rreshqitese - Boje vaji siperfaqe druri - Parapet shkalle e ballkone hekur Ø e korimano druri - Boje vaji siperfaqe metalik 	101 – 200 milion lekë	157,195,188 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - F.V zgara dekorative hekuri me konfiguracion mesatar - Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm - Boje hidroplastike - Shtrese me pllaka porcelanat - Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama - Veshje kornize llamarine bakri t = 0.8 mm - Kasete shkarkimi me llamarine bakri 1.0mm - Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine baker 33cm - Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm - Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B - Fuga me llamarine xingato - Mur me tulla te veçanta oxhak deri 50m - Mur me tulla te plota zak deri 3m, llaç perzier M 15 - Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi - Suvatim shpatullash ne rikonstruksion - Breza b/a monolit C 16/20 - Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m - Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m - Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 - Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m - Themel e xokol b/betoni C - 12/15 - F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm - Pedane druri (binare+derrase+parket) - F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm - Spostim paneli diellor - F.V. Ulluk shkarkimi vertikal bakër Φ100 - F.V. fletë plumbi (pikatore) - Çati me kapriata dërrase HD~12m mbuluar tjegulla vendi - Skele me tubo fasade ~ 8m - Skele me tubo tavani ~ 8m - Parapet shkalle e ballkone mur tulle+suva+korimano druri - Boje hidroplastike cilesi e larte - F.V porte metalike dekorative rreshqitese - Boje vaji siperfaqe druri - Parapet shkalle e ballkone hekur Ø e korimano druri - Boje vaji siperfaqe metalik - F.V zgara dekorative hekuri me konfiguracion mesatar - Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm - Boje hidroplastike - Shtrese me pllaka porcelanat - Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama - Veshje kornize llamarine bakri t = 0.8 mm - Kasete shkarkimi me llamarine bakri 1.0mm - Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine baker 33cm - Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm - Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B - Fuga me llamarine xingato - Mur me tulla te veçanta oxhak deri 50m 		
--	--	---	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - Mur me tulla te plota zak deri 3m, llaç perzier M 15 - Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi - Suvatim shpatullash ne rikonstruksion - Breza b/a monolit C 16/20 - Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m - Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m - Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 - Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m - Themel e xokol b/betoni C - 12/15 - F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm - Pedane druri (binare+derrase+parket) - F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm - Spostim paneli diellor - F.V. Ulluk shkarkimi vertikal bakër Φ100 - F.V. fletë plumbi (pikatore) - Çati me kapriata dërrase HD~12m mbuluar tjegulla vendi 		
N.P-4 B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	<ul style="list-style-type: none"> - Shtrese stabilizant t=15cm - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese rere - Shtrese betoni C 16/20 - Shtrese derrasa FM 2.5cm - Shtrese stabilizant t=15cm - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese rere - Shtrese betoni C 16/20 - Shtrese derrasa FM 2.5cm - Shtrese me pllaka terrakote 	21-50 milion lekë	26,905,337 leke
N.P-5 D	Punime nëntoksore, ura e vepra arti.	<ul style="list-style-type: none"> - F.V. Tuba metalik D=140mm - F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm - Struktura monolite betoni C 16/20 - Struktura monolite betoni C 20/25 - Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm - Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me gratar guri - Shtrese me pllaka guri natyror 8 cm - Shtrese llaç-çimento t=4cm - F V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d=90 mm - Kosh mbeturinash - Vend qendrim bicikletash - F.V. Tuba metalik D=140mm - Mbushje me cakell pas mureve - Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize - Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm - F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm - F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm - Struktura monolite betoni C 20/25 - Struktura monolite betoni C 16/20 	101 – 200 milion lekë	109,085,561 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - Veshje fasade me pllaka guri - Veshje kornize llamarine bakri t = 0.8 mm - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm - F.V. pusete shkarkimi b/a 150x150cm, h=150-200cm, t=25cm - Ndertim Pusete kontrolli b/a, Ø0.6 m, h=1.5 m - F.V. Shtrese me pllaka guri natyror 8 cm - Shtrese llaç-çimento t=4cm 		
N.P-11 C	Ndertime per n/stacionet, kabinat e transformatoreve linja TN e te mesëm dhe shpërndarjesh e energjisë.	<ul style="list-style-type: none"> - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm - FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 - FV elektroda tokezimi te xinguar 50x3mm L=150cm - F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement - F.V. shirit sinjalizimi per kablllo 20 kv - F.V. shirit sinjalizimi per kablllo 20 kv - F.V.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesse plastmasi, te armuar, 4x25mm² - F.V.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesse plastmasi, te armuar, 4x10mm² - F.V.ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesse plastmasi, te armuar, 3x10mm² - FV. në tokë kabëll fuqie 0.6/1kV, XLPE, AL-4x120mm² - FV. në tokë kabëll fuqie 0.6/1kV, XLPE, AL-4x95mm² - FV. në tokë kabëll fuqie 0.6/1kV XLPE, AL-4x70mm² - FV. Kabell koaksial TU Cu (1x6/6) mm² - F.V. Kasete metalike me zbara bakri 50x40x25cm per I=330A - F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar, L=1.5m - F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm² - F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm² - Vendosje tabela sinjalizimi (cope 2) - F.V Ndricules LED 4m 39 W, 230 V, 3323 lm, 3000 k (I kompletuar) - F.V Ndricules Mural, 220-230 V, 1400 lm, 3000 k (I kompletuar) - F.V Ndricules Fasade 7 W (I kompletuar) - Blloku I ushqimit (morseteri 3P+sig 16 A + kapak) - Koka kabllli fuqie deri 1000 V, te brendeshme, te thata, per kablllo 4x(10÷25)mm² - FV. PVC Tub ø 160 mm² me parete te trasha, trashesia e paretit 9.5 per mbrojtjen e kabllit elektrik nen toke - F.V. Tub Fleksibel Ø =50 mm - FV. kabëll fuqie 0.6/1kV Cu 4x10mm² iz.XLPE - F.V. Kapikorda te izoluar Tubolare bimetalike AL-CU per percjelles 70mm² - F.V. Kapikorda te izoluar Tubolare bimetalike AL-CU per percjelles 95mm² - F.V. Kapikorda te izoluar Tubolare bimetalike AL-CU per percjelles 120mm² - FV. Mbrojttese mekanike kabllli (Tub i galvanizuar " 3" per mbrojtjen e kabllit) L=2.5ml - FV. Fasheta metalike. jashteme. vetbllokuese 0.25x12x1200mm per fiksimin e kabllit ne shtylle - F.V. Morsete Tokëzimi - F.V. Bokse Kolektiv (21+2) - F.V Bulona e dado te zinkuar - F.V. Kapikorda Tubolare CU per percjelles 10mm² 	51 – 100 milion lekë	78,298,015 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm - FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 - FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm - F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement - F.V. shirit sinjalizimi per kablo 20 kv - F.V.ne toke kablo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesse plastmasi, te armuar, 4x25mm² - F.V.ne toke kablo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesse plastmasi, te armuar, 4x10mm² - F.V.ne toke kablo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesse plastmasi, te armuar, 3x10mm² - FV. në tokë kabëll fuqie 0.6/1kV, XLPE, AL-4x120mm² - FV. në tokë kabëll fuqie 0.6/1kV, XLPE, AL-4x95mm² - FV. në tokë kabëll fuqie 0.6/1kV XLPE, AL-4x70mm² - FV. Kabell koaksial TU Cu (1x6/6)mm² - F.V. Kasete metalike me zbara bakri 50x40x25cm per I=330A - F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar, L=1.5m - F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm² - F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm² - Vendorsje tabela sinjalizimi (cope 2) - F V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d=90 mm - F.V Ndricules LED 4m 39 W, 230 V, 3323 lm, 3000 k (I kompletuar) - F.V Ndricules Mural, 220-230 V, 1400 lm, 3000 k (I kompletuar) - F.V Ndricules Fasade 7 W (I kompletuar) - Blloku I ushqimit (morseteri 3P+sig 16 A + kapak) - Koka kablli fuqie deri 1000 V, te brendeshme, te thata, per kablo 4x(10÷25)mm² - Kosh mbeturinash - Vend qendrim bicikletash - FV . PVC Tub ø 160 mm² me parete te trasha ,trashesia e paretit 9.5 per mbrojtjen e kabllit elektrik nen toke - F.V. Tub Fleksibel Ø =50 mm - Kabëll fuqie 0.6/1kV Cu 4x10mm² iz.XLPE - F.V. Kapikorda te izoluara Tubolare bimetalike AL-CU per percjelles 70mm² - F.V. Kapikorda te izoluara Tubolare bimetalike AL-CU per percjelles 95mm² - F.V. Kapikorda te izoluara Tubolare bimetalike AL-CU per percjelles 120mm² - FV. Mbrojttese mekanike kablli (Tub i galvanizuar " 3" per mbrojtjen e kabllit) L=2.5ml - F.V. Fasheta metalike. jashteme. vetbllokuese 0.25x12x1200mm per fiksimin e kabllit ne shtylle - F.V. Morsete Tokëzimi - Boks Kolektiv (21+2) - F.V. Bulona e dado te zinkuar - F.V. Kapikorda Tubolare CU per percjelles 10mm² 		
N.P- 1 2 A	Punime te inxhinjeris e mjedisit.	<ul style="list-style-type: none"> - F.V mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar (cdo 6m) - F.V mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar (cdo 6m) 	0-20 milion lekë	659,082 leke

N.S-1. B	Punime per prishjen e ndertimem e	<ul style="list-style-type: none"> - Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese - Heqje vetrate duralumini ekzistuese - 2. PRISHJE - Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh - Prishje çatie ekzistuese me tjegulla - Prishje suvatim i jashtëm - Prishje shtresa betoni - Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh - Prishje mur tulle me pastrim - Prishje kollona, trare b/a - Prishje mur tulle pa pastrim - Prishje soleta b/a - Heqje pllaka dyshemeje - Heqje dysheme druri (binare druri + derrase + parket) - Heqje ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingato - Heqje ulluk shkarkimi plastik vertikal - Heqje e grilave ekzistuese - Prishje kornize dërrase - Çmontim dhe rimontim kondicioneresh/aspirator ne fasade - Heqje qepena+tenda+reklama - Çmontim kaseta shkarkimi - Heqje ndriccuesish - Prishje catmaje nga te dy anet - Prishje e veshjes se fasades me pllake terakote - Prishje kangjella - Heqje/Çmontim strukture/zbritje - Cmontim, zbritje ,sistemim, seleksionim, tjegulla me pastrim - Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese - Heqje vetrate duralumini ekzistuese - 2. PRISHJE - Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh - Prishje çatie ekzistuese me tjegulla - Prishje suvatim i jashtëm - Prishje shtresa betoni - Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh - Prishje mur tulle me pastrim - Prishje kollona, trare b/a - Prishje mur tulle pa pastrim - Prishje soleta b/a - Heqje pllaka dyshemeje - Heqje dysheme druri (binare druri + derrase + parket) - Heqje ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingato - Heqje ulluk shkarkimi plastik vertikal - Heqje e grilave ekzistuese - Prishje kornize dërrase - Çmontim dhe rimontim kondicioneresh/aspirator ne fasade - Heqje qepena+tenda+reklama - Çmontim kaseta shkarkimi - Heqje ndriccuesish 	21-50 milion lekë	49,315,756 leke
----------	-----------------------------------	---	-------------------	-----------------

		<ul style="list-style-type: none"> - Prishje catmaje nga te dy anet - Heqje/Çmontim strukture/zbritje - 1. PRISHJE - Prishje shtresa betoni - Prishje mur blloqe betoni - Prishje trotuari ekzistues - Prishje struktura prej guri - Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri - Prishje e rrjetit ekzistues KUB - Prishje objektesh ekzistuese - 1. PRISHJE - Prishje shtresa betoni - Prishje mur blloqe betoni - Prishje trotuari ekzistues - Prishje struktura prej guri - Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri - Prishje e rrjetit ekzistues KUB - Prishje e rrjetit ekzistues KUZ - Prishje objektesh ekzistuese 		
N.S-2. A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	<ul style="list-style-type: none"> - F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=25mm, t = 2.0 mm, Pn 10 - F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 	0-20 milion lekë	11,241 leke
N.S-18. A	Punime topogjeode zike.	<ul style="list-style-type: none"> - Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik 	0-20 milion lekë	
N/Z/A/5; N/Z/A/6; N/Z/A/7	Punime Restaurimi	<ul style="list-style-type: none"> - Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik 		93,582,620 leke

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (dy) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin e objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi i stafit kryesor:

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

Inxhinier Ndërtimi & Inxhinjer për kontrollin e cilësisë.	- Punime gërmimi në tokë - Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista - aeroportuale - Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti
Inxhinier Hidroteknik	- Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
Inxhinier Mekanik	- Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik
Inxhinier Elektrik	- Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike
Inxhinier Gjeodet	- Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik
Inxhinier Mjedisi	- Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik
Inxhinjer/Inspektor për HSE.	- Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik si dhe legjislacionit në fuqi për shëndetin dhe sigurinë në punë.
Restaurator (drejtues teknik)	- Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik si dhe legjislacionit në fuqi për punimet e restaurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet te jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohet te jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 170 persona** për periudhën, 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fitesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve projektuesi ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre muaj, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **170** persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport) zëri fuqi punëtore zë rreth 20% të kostos.

Total ore pune= 478,720 ore (referuar oreve të punës për çdo zë pune të preventivit)

Ore/1 dite pune= 8 ore

Total Dite pune puntori= 478,720 ore/8 ore= 59,840 dite pune

Dite pune gjithsej= 16 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 22 dite/muaj= 352 dite pune

Numri i fuqisë punëtore = 59,840 dite / 352 dite = 170 puntore

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi/qira/kontrate furnizimi).

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
1	Ekskavator me Zinxhir	Copë	2	Ne pronësi ose me qera
2	Ekskavator me Goma	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
3	Kamion vetëshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Copë	2	Ne pronësi ose me qera
4	Kamion vetëshkarues me kapacitet mbajtës 10 deri 20 Ton	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
5	Kamioncine	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
6	Kamion me Vinc	Copë	1	Ne pronësi ose me qera

7	Fadroma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
8	Miniekskavator	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
9	Greider	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
10	Autobot Uji	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
11	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
12	Autopompe	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
13	Rul Gome-Hekur	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
14	Skeleri	m2	6000	Ne pronesi ose me qera

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet për gjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronesi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Argumentimi i mjeteve është si mëposhtë:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
1	Ekskavator me Zinxhir	Copë	2	Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m ³ , ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk ne toke
2	Ekskavator me Goma	Copë	1	-Prishje trotuari ekzistues -Prishje struktura prej guri -Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri -Prishje e rrjetit ekzistues KUB -Prishje e rrjetit ekzistues KUZ -Prishje objektsh ekzistuese
3	Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	Copë	2	-Shtrese stabilizant t=15cm Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. -Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri. Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km -Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 7.0 km -Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km
4	Kamion veteshkarues me kapacitet mbajtës 10 deri 20 Ton	Copë	1	-Prishje çatie ekzistuese me tjegulla. -Prishje suvatim i jashtem -Prishje shtresa betony. -Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh. -Prishje mur tulle me pastrim. -Prishje kollona, trare b/a. -Prishje mur tulle pa pastrim. -Prishje soleta b/a -Heqje pllaka dyshemeje -Heqje dysheme druri (binare druri + derrase + parket) -Heqje ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingato -Heqje ulluk shkarkimi plastik vertikal -Heqje e grilave ekzistuese -Prishje kornize dërrase -Prishje mur bloqe betoni -Prishje trotuari ekzistues -Prishje struktura prej guri -Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri -Prishje e rrjetit ekzistues KUB -Prishje e rrjetit ekzistues KUZ -Prishje objektsh ekzistuese

5	Kamioncine	Copë	1	<ul style="list-style-type: none"> -Transport I materialeve/veglave ne kantier. -Transport I puntorise
6	Kamion me Vinc	Copë	1	<ul style="list-style-type: none"> -F.V zgara dekorative hekuri me konfiguracion mesatar -Shtrese me pllaka porcelanat -Mur me tulla te veçanta oxhak deri 50m -Mur me tulla te plota zak deri 3m, llaç perzier M 15 -F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm -F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm -Pedane druri (binare+derrase+parket) -Spostim paneli diellor -Çati me kapriata dërrase HD~12m mbuluar tjegulla vendi -F.V porte metalike dekorative rreshqitese -Shtrese me pllaka porcelanat -Mur me tulla te plota zak deri 3m, llaç perzier M 15.
7	Fadroma	Copë	1	<ul style="list-style-type: none"> -Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm -F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm -Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me gratar guri -Shtrese me pllaka guri natyror 8 cm -F V tuba te brinjezuar HDPE SN4 d=90 mm -F.V. Tuba metalik D=140mm -Mbushje me cakell pas mureve. -Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize -Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm -F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm -F.V. pusete shkarkimi b/a 150x150cm, h=150-200cm, t=25cm -Ndertim Pusete kontrolli b/a, Ø0.6 m, h=1.5 m
8	Miniekskavator	Copë	2	<ul style="list-style-type: none"> -Prishje mur blloqe betoni -Prishje trotuari ekzistues -Prishje struktura prej guri -Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri -Prishje e rrjetit ekzistues KUB -Prishje e rrjetit ekzistues KUZ
9	Greider	Copë	1	<ul style="list-style-type: none"> -Shtrese stabilizant t=15cm Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. -Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri.
10	Autobot Uji	Copë	1	<ul style="list-style-type: none"> -Shtrese stabilizant t=15cm Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. -Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri.

11	Autobetoniere	Copë	1	-Breza b/a monolit C 16/20 -Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m -Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m -Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 -Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m -Themel e xokol b/betoni C - 12/15
12	Autopompe	Copë	1	-Breza b/a monolit C 16/20 -Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m -Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m -Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25 -Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m -Themel e xokol b/betoni C - 12/15
13	Rul Gome-Hekur	Copë	1	-Shtrese stabilizant t=15cm Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri. -Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri.
14	Skeleri	m2	6000	-Prishje suvatim i jashtem -Heqje ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingato -Heqje ulluk shkarkimi plastik vertikal -Heqje e grilave ekzistuese -Prishje kornize dërrase -Çmontim dhe rimontim kondicioneresh/aspirator ne fasade -Heqje qepena+tenda+reklama -Prishje e veshjes se fasades me pllake terakote. -Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese -Heqje vetrate duralumini ekzistuese. -

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të komformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në original ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

-Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe. Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët	65
2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shitesë	pikët	10
3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët	15
4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)	pikët	5
5. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)	pikët	5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 65] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë

[0 –10 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këto kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshtë:

- *Punime shtesë me pllaka guri natyror me sipërfaqe jo më pak se 8,000 m² për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjeçare, gjatë pesë viteve të fundit* 5 pikë

- *Punime për restaurimin e fasadave me sipërfaqe jo më pak se 13,120 m² për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjeçare, gjatë pesë viteve të fundit* 5 pikë

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 1 vjeçar, afat i cili nënkupton një periudhë 12 muajore të pandërprere gjatë 5 viteve kalendarike. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punimeve dhe volumeve të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Përmbushja e këtij kriteri do të provohet nepermjet situacioneve perfundimtare sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik si dhe dorezimit të detyrueshem të informacionit të përmbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–15 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qënë i detyruar të zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe pajisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k3}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k3}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k3}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) [0 - 5 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k4}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k4}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k4}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: *Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.*

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) [0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubriken specifike/zerin “Siguria në kantier (Plani I Sigurisë e Kordinimit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, datë 13.04.2023)”, në preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë

13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrikë në masën jo më pak se 3%, përllëgëritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se **15,849,564.42** leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Permbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zërin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 15,849,564.42 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 15,849,564.42 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 15,849,564.42 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përllëgëriten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilësia në punime: siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shumë se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilësia në punimet e kryera: siguria në kantier/shendeti impakti në mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)

Mo – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

PR (R_{rm}) – Rritje e mundshme

Mo = $O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N$

PR = 200 % Mo

Vlera e ofertave të ofruara > PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilësia në punimet e kryera: siguria në kantier/shendeti impakti në mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK ($200\% MO = 51,500,000 \text{ leke} < 55,000,000 \text{ leke}$) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlere per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlere korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve jane pjese e pandare e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.